



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**MINISTRIA E BRENDSHME**

Nr. \_\_\_\_\_ prot. Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot. Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

### **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NË FUNKSION TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR,  
MIRATUAR ME VKM NR. 637, DATË 06. 11. 2017**

*Nisur nga fakti që*, deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, sfera e veprave penale objekt i kësaj Marrëveshjeje, janë kompetencë lëndore si e Prokurorisë për Krime të Rënda ashtu dhe të prokurorive të rretheve gjyqësore me juridiksion të zakonshëm;

*Me qëllim* forcimin e bashkëpunimit në luftë kundër krimit të organizuar, pjesëtarëve të grupeve të strukturuar e organizatave kriminale, aseteve dhe të ardhurave të tyre të paligjshme, si dhe rritjen e efektivitetit në hetimet penale dhe vënien përpara drejtësisë të autorëve;

*Në mbështetje* të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar, ligjit nr. 97/ 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 14, 20, 21, 38 pika 1, pika 2 shkronjat “b”, “e”, “ë” dhe “f”, nenit 46, pika 3, shkronjat “a” dhe “c”, Ligjit Nr. 96/ 2017 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni 160, pika 4, VKM nr. 637, datë 06. 11. 2017, “Për miratimin e planit të veprimit për luftën kundër krimit të organizuar, operacionit “Forca e Ligjit”, Urdhrit nr. 204, datë 23. 11. 2017 të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e Task Forcës Qendrore Ndërinstitucionale të ngarkuar me përgjegjësinë e zbatimit të Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar, operacioni “Forca e Ligjit”;

## **Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Brendshëm arrijnë marrëveshjen si më poshtë:**

### **Objekti**

Objekti i veprimtarisë së kësaj Marrëveshje është hetimi i specializuar, i shpejtë, i gjithanshëm i grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në fushën e krimit të organizuar dhe, kryesisht grupet kriminale të trafikimit të narkotikëve, krimeve të rënda me ndikim të lartë shoqëror, krimit kundër korrupsionit dhe atij financiar, sekuestrimin e asetëve kriminale, me fushë veprimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

### **1. Detyrimet e Prokurorisë së Përgjithshme**

1/ 1 Prokuroria e Përgjithshme merr përsipër që të krijojë *Seksione të Posaçme* të përkohshme, në Prokurorinë për *Krime të Rënda*, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, *Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Gjirokastër, Lezhë*.

1/ 2 Kompetenca lëndore e këtyre seksioneve do të jenë krimet në fushën e krimit të organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, krimet në ekonomi, krimet e kryera nga subjekte të posaçme, sipas pikës 3 të Marrëveshjes.

1/ 3 Prokurorët që do të caktohen në Seksionet e Posaçme do të kalojnë paraprakisht një proces verifikimi të pasurisë dhe integritetit nga Prokuroria e Përgjithshme. Ky proces do të realizohet në bashkëpunim me SHISH-in, ILDKPI-në dhe DSIK-në. Personat që nuk kalojnë këtë proces, nuk do të jenë pjesë e këtyre seksioneve.

1/ 4 Prokuroria e Përgjithshme, brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, cakton prokurorët në këto seksione ku, një nga prokurorët do të jetë edhe drejtues i seksionit.

1/ 5 Drejtuesit e Prokurorive ku krijohen këto seksione krijojnë mjedise të veçanta për prokurorët si dhe u sigurojnë shërbime mbështetëse të posaçme. Në raste të veçanta, në varësi të numrit të çështjeve, sipas kompetencës lëndore të kësaj Marrëveshjeje, drejtuesi i prokurorisë mund të përfshijë prokurorët e seksionit në hetime të çështjeve të tjera, që mund të jenë sensitive për publikun.

1/ 6 Kompetencat dhe veprimtaria e këtyre seksioneve në përbërje të strukturës së Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Gjirokastër, Lezhë dhe Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, do të ushtrohen bazuar në aktet ligjore në fuqi dhe në këtë Marrëveshje.

1/ 7 Pranë Prokurorisë së Përgjithshme caktohet një prokuror/ *Koordinator* ndërmjet *Seksioneve të Posaçme* dhe *Task - Forcës Speciale Qendrore*. Brenda datës 10 të çdo muaji,

seksionet duhet të raportojnë të dhëna statistikore te Kordinatori në Prokurorinë e Përgjithshme, sipas formularit që do të miratohet.

1/ 8 Në rastet kur një nga veprat penale, objekt i kësaj Marrëveshjeje kryhet në rrethet ku nuk mund të ngrihen seksione sipas ligjit, Prokurori i Përgjithshëm mund të caktojë përkohësisht prokuror nga seksionet e prokurorive brenda qarkut ku ndodh vepra penale ose nga qarqet më të afërta.

1/ 9 Prokurorët e caktuar në këto seksione bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira në *Task - Forcë*, për kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të përbashkëta rreth grupeve kriminale si dhe realizimin e veprimtarisë hetimore, në zbatim të detyrimeve specifike, të përcaktuara në “Planin e Veprimit kundër Krimin të Organizuar, Operacioni “Forca e Ligjit”.

1/ 10 Për të shmangur nxjerrjen e sekretit hetimor, shërbimet e policisë gjyqësore dërgojnë materialet në këto seksione në mënyrë të drejtpërdrejtë, jashtë shërbimit postar. Drejtuesi i seksionit, shorton materialet duke caktuar prokurorin të cilit i caktohet materiali hetimor.

1/ 11 Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, Prokuroria e Përgjithshme nxjerr akte dhe udhëzime në zbatim të tij.

## **2. Detyrimet e Ministrisë së Brendshme**

2/ 1 Ministria e Brendshme, nëpërmjet përfaqësuesve të saj në *Task - Forcën Speciale Qendrore, Task - Forcat Speciale Rajonale*, bashkëpunon me prokurorët e caktuar në *Seksionin e Posaçëm* për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në “Planin e Veprimit për luftën kundër krimin të organizuar, Operacioni “Forca e Ligjit”.

2/ 2 Ministria e Brendshme siguron mjediset e punës, mjetet logjistike që do të përdoren në këto mjedise si dhe personelin ndihmës për prokurorët, në ato raste kur prokurorët do të kryejnë veprime në mjediset e *Task - Forcës Speciale Qendrore* dhe *Task - Forcës Speciale Rajonale*.

2/ 3 Ministria e Brendshme siguron automjete në mbështetje të prokurorëve, në funksion të hetimit të çështjeve, në një kohë sa më të shpejtë.

2/4. Ministria e Brendshme siguron mbrojtje dhe siguri fizike për prokurorët dhe familjet e tyre kur u vihet në rrezik jeta, shëndeti apo pasuria e tyre dhe e familjes.

2/5. Ministria e Brendshme siguron që struktura e *Task - Forcës* që ka ndjekur një hetim të veçantë, vazhdon të jetë pjesë e grupit të hetimit deri në përfundim të gjykimit të çështjes, në

funksion të sigurisë fizike të prokurorit në seancat gjyqësore dhe jashtë saj, duke ndihmuar prokurorin me mjete logjistike gjatë gjykimit të çështjes.

2/ 6 Punonjësit e *Task - Forcës Speciale Qendrore* dhe *Task - Forcave Speciale Rajonale*, me atributet e policisë gjyqësore, janë të detyruar të informojnë për çdo veprim të ndërmarrë prokurorin e ngarkuar me drejtimin e hetimeve të çështjes konkrete, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

### **3. Veprat penale**

Veprat penale që referohen në Seksionet e Posaçme, sipas kompetencës lëndore nga *Task - Forca Speciale Qendrore* dhe *Task - Forca Speciale Rajonale*. *Referenca* (Dispozita kalimtare e Ligjit nr 35/2017).

3/ 1 Vepra penale në fushën e lëndëve narkotike dhe pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

3/ 2 Vepra penale kundër korrupsionit.

3/ 3 Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën e ekonomisë, shoqërive tregtare.

3/ 4 Vepra penale në fushën e tatim - taksave.

3/ 5 Sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale, sipas ligjit Nr. 10 192, datë 03. 12. 2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar,

3/ 6 Vepra penale të kryera nga subjekte të posaçme, të përcaktuar në nenin 135/ 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### **Dispozita të fundit**

1. Secila palë merr përsipër të bashkëpunojë me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.
2. Për çdo rast të mospërbushjes së detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, përfaqësuesit e secilës palë informojnë titullarin e institucionit.
3. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet deri në krijimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme.
4. Marrëveshja hartohet në 2 (dy) kopje, nga 1 (një) kopje për secilën palë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**Arta MARKU**

**MINISTRI I BRENDSHËM**

**Fatmir XHAFAJ**